

Datë 01/10/2019

### KONTRATË SHITJE KUOTE

**Shitësi:** Z. Recep SEKERCI, shtetas turk, i biri i Haki, lindur më 15.03.1978, në **SUCATI / TURQI**, banues në adresën Rruga Frderik Shiroka, 21 Dhjetori, Pallatet Gora, Kulla nr. 2, Kati 2, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. U 02922150.  
(në vijim "**Shitësi**")

dhe

**Blerësi:** Z. Aytekin AYDIN, shtetas turk, i biri i Yusuf, lindur më 25.01.1971, në **HAFIK / TURQI**, banues në adresën Rruga Frederik Shiroka, 21 Dhjetori, Pallatet Gora, Kulla nr. 2, Kati 2, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pashaportës turke nr. U 11560957.  
(në vijim "**Blerësi**")

#### MEQENËSE:

- A. Z. Recep Sekerci është ortak me 50% të kuotave të shoqërisë tregtare "Terye Tekstil" Sh.P.K., një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L82417030D, me seli në adresën: Vaqar, Tiranë, Shqipëri (me poshtë referuar "**Shoqëria**"), dhe zotëron 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, konkretisht një (1) kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit prej 100 (njëqind) lekësh të Shoqërisë.
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe ky i fundit dëshiron të blejë nga Shitësi 20% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë, në mënyrë që Blerësi të bëhet ortak duke zotëruar 20% (njëzetë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontrate.

#### NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon ne pronësinë ligjore të Blerësit 20% (njëzetë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi blen 20% (njëzetë përqind) të kuotave, duke u bërë kështu ortak i Shoqërisë, kundrejt çmimit të shitjes dhe sipas kushteve e afateve të përcaktuara këtu.
2. Çmimi i shitjes së 20% të kuotave të kapitalit është i njëjtë me vlerën nominale të tyre në shumën prej LEK 20 (njëzetë lekë) dhe Palët vërtetojnë se pagesa e çmimit të mësipërm të shitjes është kryer tërësisht nga Blerësi në favor të Shitësit me lidhjen e kësaj Kontrate dhe



kjo Kontrate shërben edhe si një dëftesë për vërtetimin e pagimit të shumës. Palët e vërtetojnë shlyerjen e çmimit dhe nuk kanë asnjë pretendim tjetër të asnjë lloji.

3. Me lidhjen e kësaj Kontrate Blerësi bëhet ortak i Shoqërisë, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë me vlerë prej 20 (njëzetë) lekë dhe njëkohësisht Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të pronësisë së vet mbi kuotën në librin e ortakëve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.
4. Shitësi deklaron dhe garanton se 20% e pjesëve të kapitalit të transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë në pronësinë e vetme e të plotë ligjore të Shitësit dhe janë të lira nga barra, të drejta të tjera reale apo pengje apo të drejta të çfarëdolloji të palëve të treta mbi to.
5. Blerësi deklaron dhe garanton se e njeh gjëndjen e Shoqërisë dhe se ka verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë ne tërësi dhe për këtë nuk ka dhe shprehimisht heq dore nga çdo rezerve, pretendim apo padi kundër Shitësit.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotës objekt të kësaj Kontrate në librin e ortakëve si dhe në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave të ligjit.


Kjo Kontrate u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Nr. 9901, date 14.04.2008.

Kontrata i’u lexua Palëve nëpërmjet përkthimit simultan nga gjuha shqipe në gjuhën turke nga Përkthyesi i Gjuhës Turke Altin Kodra dhe Palët pasi e kuptuan Kontratën, e gjetën atë rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë duke e nënshkrua atë rregullisht.


**SHITËSI**


**z. RECEP SEKERCI**

  
RECEP SEKERCI

**BLERËSI**

**z. AYTEKIN AYDIN**

  
Aytekin Aydın

Përkthyes  
Altin Kodra  


ALTIN KODRA  
Përkthyes Zyrtar  
Official Translator